

SPECIFIKIME TEKNIKE - PROJEKTI HIDROTEKNIK

Objekti:

**“PROJEKT ZBATIM, ZGJERIM E SHTESE KATI TE ARIVIT QENDROR
TEKNIK TE NDERTIMIT (AQTN), TIRANE”**



POROSITES:



ARKIVI QENDROR TEKNIK I NDERTIMIT

KONSULENT:



"TAULANT" SHPK

Prill 2026

Fikësit e zjarrit

Fikësit e zjarrit mund ti ndajme në këto tipe:

Tipe të fiksuara

- Hidrante brenda ndërtesës
- Hidrante jashtë ndërtesës

Tipe mobile

- Bombula të ndryshme

Projektuesi i MKZ duhet sipas nevojës dhe normave të vendosë dhe të projektojë një plan efektiv, sipas të cilit do të instalohen fikësit e nevojshëm. Më poshtë janë paraqitur disa sisteme, ndër të cilat projektuesi mund të zgjedhë.

Fikësit e zjarrit janë komponente aktive të mbrojtjes kundër zjarrit. Nuk duhet harruar edhe komponenti pasiv, siç është zgjedhja e materialeve kundër zjarri.

Tubat e hidrantit

Hidrantët që gjenden brenda një ndërtese duhet të jenë të tipit të përshkruar dhe paraqitur më poshtë ose të ngjajshme.

Një hidrant përbëhet prej saraçineskës (hidrante), tubit, linit dhe kutisë në të cilën ata janë të vendosura.

Tubat e hidrante janë të shumëllojshme sipas nevojës dhe prodhuesit. Ata kanë si zakonisht një gjatësi prej maksimal 30 m. Për raste të veçanta duhet kontaktuar prodhuesi i hidranteve dhe të gjendet një zgjidhje e veçantë.

Kutia e hidrantit mundet të fiksohet në mure, por rekomandohet që ajo të futet në mure brenda në atë mënyrë, që kapaku i kutisë të ketë një nivel me murin. Ky sistem i vendosjes është me i sigurt, sidomos kur bëhet fjalë për ndertime publike, shkolla etj.

Në kutinë e hidrantit mund të integrohet edhe një bombulë fikëse kundër zjarrit, siç është e paraqitur në fotografitë e mëposhtme, prodhime gjermane.

Tubacionet e furnizimi me uje te hidranteve te brendeshme (Naspove)

Kollona e tubit qe vjen nga pompa e sherbimit te MNZ eshte tub zingato I cili furnizon te 2 linjat e kraheve me tub 1.1/4" zingato.Tubat zingato te dy dimesioneve do te plotesojne Sandartet shteterore ne fuqi

Hidrantet e brendeshme



Hidrantet e jashtme mbitoksor



Pompat e lëshimit të ujit MNZ

Në raste zjarri zjarrfikësit duhet të kenë furnizimin e plotë me ujë të posaçëm për ta luftuar zjarrin. Kjo arrihet duke vendosur hidrante brenda dhe jashtë ndërtesës. Hidrantet duhet të kenë një sasi uji me një shtypje (presion), të mjaftueshëm. Në rast të mungesës së ujit nga rrjeti komunal apo të mungesës së presionit të tij, duhet të projektohen pompa të cilat e garantojnë presionin e nevojshëm për të luftuar zjarrin nga zjarrfikësit.

Po ashtu duhet patur parasysh, në raste të mungesës së ujit, të gjenden burime të tjera të ujit me një sasi të mjaftueshme.

Këto kërkesa duhen plotësuar sipas normave / standardeve moderne. Po ashtu duhet gjatë projektimit të ndërtesës të kontaktohen autoritetet e zjarrfikësve për të plotësuar kërkesat e atyre për një nderhyrje të sukseshme në raste zjarri. Parametrat e pompes të shërbimit të MNZ do të jenë:

Elektropompe shërbimi me

- Kapacitet .prurje $Q = 2 \times 10.5 \text{ m}^3/\text{h}$
- Lartësia max e ngritjes së ujit $H_{\text{max}} = 50\text{m}$
- Prurja $q = 2970 \text{ lit/min}$
- Dalje e tubacioni : 2"
- Fuqia elektrike $N = 2 \times 3.0 \text{ kw}$
- Tensioni dhe frekuenca : 3F ~400V, 50Hz
- Intesiteti I rrymes $a = 6.1\text{A}$

Ene zgjerimi me membrane

- Presioni max : 10 bar
- Presioni i punës : 1.5 bar
- Volumi : 200 lit Dimesionet ,lartesi 1065 mm,diameter 600 mm
- Dalje : 1.1/2" (DN 32)

9.6.4 Bombulat fikëse

Sipas normave/standardeve bashkëkohore bombulat fikëse ndahen në klasa. Për shembull evropiane DIN EN 2 i ndan bombulat në këto klasa :

Klasa A:

Përdoret për zjarre që rezultojnë nga materiale të forta si psh.: Dru, letër, tekstile, plastike, etj

Klasa E:

Përdoret për pajisje elektrike që janë nën tension.

Në projekt janë përcaktuar me saktësi zonat sipas të klasit të zjarrit dhe në përputhje me to janë zgjedhur lloji i fikseve portative (bombolave) si dhe hidratet e zjarrit.



kg	m3	d(mm)	h(mm)	Tip punienja
1	1.7	85	280	prf
3	5.1	160	365	prf
6	10	160	440	prf
12	20	190	640	prf
1	1.7	85	280	HFC227*
3	5.1	160	365	HFC227*
6	10	160	440	HFC227*
12	20	190	640	HFC227*
6	-	170	440	prf
12	-	190	640	prf

Sasia e bombolave fikëse duhet të vendoset nga projektuesi i ndërtimit sipas kërkesave të normave/standardeve bashkëkohore dhe modern. Ata duhet të mirëmbahen dhe të kontrollohen të paktën çdo dy vjet nga autoritetet e licensuara.

"TAULANT" SHPK

Ing. Ditika Qatipi